

## Kujdes nga mashtrimet dhe dredhive gjatë pandemisë COVID-19

### Kriminelët janë duke përdorur pandeminë COVID-19 për të mashtruar publikun - mos u bëni viktimë.

COVID-19, sëmundja e shkaktuar nga virusi i ri i koronës, tani është zyrtarisht një pandemi në mbarë botën. Kriminelët në të gjithë botën po përdorin këtë krizë për të mashtruar publikun, duke shënjestruar grupet e cenueshme ndërsa kërkojnë të përfitojnë nga pandemia. Action Fraud, shërbimi kombëtar për njoftimin e mashtrimit në Mbretërinë e Bashkuar, raportoi një rritje prej 400% të mashtrimeve të lidhura me virusin korona në mars 2020.

Policia dhe organet e tjera qeveritare janë duke punuar së bashku për të shpërndarë informacione rreth këtyre mashtrimeve dhe të sigurojnë që publiku të jetë vigjilent ndaj mashtrimit.

Shërbimi i Prokurorisë së Mbretërisë ka ndarë këshillat e mëposhtme:

**Ndal:** Një moment për të menduar para se të japësh paratë ose informacionin tënd mund t'ju mbajë të sigurt.

**Sfido:** Mund të jetë false? Nuk është problem nëse refuzon ose shpërfill çdo kërkesë. Vetëm kriminelët do të përpiqen t'ju nxitojnë ose t'ju frikësojnë.

**Mbro:** Kontakto menjëherë bankën tënde nëse mendoni se je mashtruar dhe raportoje tek Action Fraud.

Ne i kemi shqyrtuar raportet e ndryshme të dredhive dhe kemi bërë një listë që ju të bëni kujdes:

\* Ju lutemi vini re se lista nuk është aspak shteruese dhe kriminelët mund të gjejnë mënyra të tjera për të synuar individët, ndaj duhet të jeni gjithmonë vigjilentë.

- Testimi i viruseve: Paketat e testimit të viruseve ofrohen vetëm nga NHS në Mbretërinë e Bashkuar.
- Vaksinat/kurat: Aktualisht nuk ka asnjë vaksinë ose kurë për COVID-19.
- Produkte të falsifikuara: Ka pasur një rritje të mallrave me çmim të lartë ose të rreme për të mbrojtur veten nga virusi korona. Këto përfshijnë xhelin antibakterial, maskat, etj.
- Sjellja e blerjeve/barnave: Kriminelët synojnë njerëzit e cenueshëm në pragun e tyre dhe ofrojnë të bëjnë blerjet e tyre ose t'ua sjellin barnat.
- Shërbimet e pastrimit: Ofrimi i shërbimeve të pastrimit për të parandaluar përhapjen e virusit.
- Emailt /mesazhet SMS mashtruese: Kujdes nga mesazhet që ju kërkojnë të hapni shtojcat keqdashëse, të cilat mund të bëjnë që mashtruesit të përftojnë qasje në informacionet personale.

E-mailt e mëposhtëm janë identifikuar nga Action Fraud:

1. Mashtrues që pretendojnë të jenë nga një grup hulumtues që imitojnë Qendrën për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) dhe Organizatën Botërore të Shëndetit (WHO). Ata pretendojnë se i sigurojnë viktimës një listë të infeksioneve aktive në zonën e tyre.
2. Mashtrues që ofrojnë artikuj në lidhje me shpërthimin e virusit me një lidhje në një faqe në internet të një kompanie të rreme, ku viktimat nxiten të klikojnë për t'u pajtuar në një gazetë ditore për azhurnime të mëtejshme.

3. Mashtrues që dërgojnë skemën e investimeve dhe këshilla tregtare që nxisin njerëzit të përfitojnë nga rënia e virusit korona.
4. Mashtrues që pretendojnë se janë nga HMRC që ofrojnë një rimbursim të taksave dhe iu ofrojnë viktimave në një faqe të rreme për të marrë detajet e tyre personale dhe financiare.

Nëse ju ose dikush që e njihni ka qenë në shënjestër të një mashtrimi, duhet ta raportoni atë në Action Fraud në internet në [www.actionfraud.police.uk/](http://www.actionfraud.police.uk/) ose duke telefonuar 0300 123 2040.

Për këshilla dhe informacion se si të kontrolloni nëse diçka mund të jetë një mashtrim, vizitoni: [www.citizensadvice.org.uk/consumer/scams/check-if-something-might-be-a-scam/](http://www.citizensadvice.org.uk/consumer/scams/check-if-something-might-be-a-scam/).

\*Ky përkthim është përgatitur mbi baza vullnetare nga ekipi ynë i mrekullueshëm i përkthyesve të pavarur\*

Gjuha: shqip Elvana Moore / Klarita Canaj